



Në bazë të nenit 98, të Statutit të Kolegjit Tempulli dhe nenit 3, paragrafi 1.9 të rregullorës së punës së Këshillit Akademik në mbledhjen e mbajtur më 29.01.2025 Këshilli Akademik miratoj këtë:

RREGULLORE PËR TRANSFER TË STUDENTEVE

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje, është përcaktimi i kritereve dhe procedurave si në vijim:

- ndrrimi i programit brenda Kolegjit Tempulli
- transferi nga Universitetet/ Kolegjet e tjera brenda dhe jashtë vendit.
- ekuivalentimi i notave dhe ECTS-kredive;

Neni 2

Periudha e Aplikimit

Aplikimet për transferim, në programin Bachelor dhe Master për semestrin dimëror është prej datës 25 Shtator deri më 30 Shtator. Ndërsa për semestrin veror BSc dhe MSc është prej datës 23 deri më 28 Shkurt.

Vendimi rreth transferimit duhet të merret brenda një jave, prej datës së aplikimit.

Neni 3

Kriteret e Aplikimit

Aplikimet për transfere ndërmjet departamenteve/programve të Kolegjit Tempulli si dhe nga institucionet tjera të arsimit të lartë do të kryhen nëse sëpaku 50% e provimeve janë dhënë me sukses në programin e tjetër.

Neni 4

Procedura dhe dokumentet e aplikimit

Studentët të cilët do të transferohen, duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë formularin dhe dokumentet përkatëse në zyrën e shërbimeve studentore. Aplikimet pasi shqyrtohen nga komisioni i studimeve dhe zyrën e shërbimeve studentore të Kolegjit përkatës, i kalohen Këshillit Akademik për miratimin përfundimtar.

Studentët të cilët do të transferohen ndërmjet programve/departamenteve të Kolegjit Tempulli duhet të paraqesin transkriptimin e notave pranë zyrën e shërbimeve studentore. Studentët të cilët do të transferohen nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë për transferim të studimeve
- Transkripti i notave
- Përshkrimi i lëndëve të programit të studimit përkatës
- Dëshmia e akreditimit të programit të studimeve

Neni 5

Ekuivalentimi i lëndëve

Njësimi i lëndëve do të kryhet me vendim të Këshillit Akademik bazuar në propozimin e komisionit të studimeve të bazuar nërregulloren e studimeve bachelor dhe master.

Neni 6

Transferimi i Kredive

Kredit e lëndëve që studentit i janë njësuar, me vendim të Këshillit Akademik të Kolegjit bazuar në propozimin nga komisioni i studimeve, do të llogariten në shumën totale të kredive të marrë në atë cikël studimit.

Neni 7

Kushtet për transferim

1. Transferimet mund të kryhen për profilet e studimit të cilat i përkasin të njëjtës fushë. Studentët të cilët dëshirojnë të kryejnë transferim në programe të ndryshme, ata pranojnë të fillojnë studimet në vitet e më poshtme, në bazë të njësimit të lëndëve.
2. Nuk mund të kryhet më shumë se një transferim gjatë studimit të programeve të ciklit të parë dhe të dytë.

Neni 8

Pagesa

Këshilli Akademik do të përcaktojë tarifën e pagesës studentit duke u bazuar në pagesën e programit që është duke studiuar dhe atë në të cilin kërkon të transferohet.

Neni 9

Ankesa kundër vendimit mbi refuzimin e ndërrimit të programit të studimit duhet t'i bëhet Këshillit Akademik brenda 15 ditëve të punës pas publikimit të vendimit.
Këshilli Akademik brenda 15 ditëve të punës pas pranimit të ankesës merr vendim përfundimtar në procedurë administrative.

Neni 10

Diplomatat e studentëve të cilët janë transferuar në Kolegjin Tempulli, u jepet diplomë, me kusht që të kenë kryer të paktën dy semestra në Kolegjin Tempulli.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Këshilli Akademik i Kolegjit dhe shfuqizohet rregullorja nr. 14/23, dt. 10/10.2023.

Kryesuesi i Këshillit Akademik
Prof. Dr. sc. Mevlan Bishaku



